

LIGJ
Nr. 8437, datë 28.12.1998
PËR AKCIZAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË
(Ndryshuar me ligjin nr. 8507, datë 7.7.1999; nr. 8595, datë 6.4.2000; nr. 8716, datë 15.12.2000; nr. 8807, datë 17.5.2001; nr. 8848, datë 19.12.2001)
(I përditësuar)

Në mbështetje të neneve 81, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Akcizat janë tatime për një numër të kufizuar mallrash për konsum masiv, të brendshëm, pavarësisht nëse prodhohen brënda vendit apo importohen.

Neni 2

Personat juridikë a fizikë, vendas dhe të huaj, që i nënshtrohen këtij tatimi, janë prodhuesit dhe importuesit e mallrave të tatueshme me akcizë.

Neni 3

(Ndryshuar me ligjin nr. 8507, datë 7.7.1999; ndryshuar në kapitullin 33 shkronja 'F' me ligjin nr. 8595, datë 6.4.2000; ndryshuar shkronja "a" dhe "b" dhe paragrafi i fundit me ligjin nr. 8716, datë 15.12.2000; hequr togfjalësh në shkronjën "dh" dhe shtuar pika 9/1 me ligjin nr. 8807, datë 17.5.2001; ndryshuar pika "c" dhe "d" me ligjin nr. 8848, datë 19.12.2001)

Vlera e akcizës për një pullë për mallrat e veçanta, që tatohen me akcizë, në përqindje janë:

Kapitulli	Kodi		Përqindja	Vlera e akcizës
	N.C.	e akcizës	për një pullë	
24	A. Duhan e prodhime duhani			
lekë/paketa	- 24.03	Duham për konsum	60	
	- 24.02	Cigare, kat.I dhe II		11
		kat.III		7 lekë/paketa
	- 24.02.1000	Puro		2.240 lekë/kg
22	B. Pije alkoolike, alkoole			
	- 22.03.00	Birrë	50	

- 22.04		Verë		
		- Me vlerë deri 300 lekë/litri	50 lekë/litri	
		- Me vlerë mbi 300 lekë/litri	150 lekë/litri	
- 22.08		Raki, konjak, uzo, vodka, fërnet, ponç, likerna, wiski, campari, rum, martini e të tjera pije alkoolike		
		- Me vlerë deri 400 lekë/litri	40 lekë/litri	
		- Me vlerë mbi 400 lekë/litri	350 lekë/litri	
- 22.07		Alkool etilik jo i denatyrar i një force alkoolike ndaj volumit prej 80 % vol. ose më e lartë, alkool etilik dhe alkool të tjera të denatyrara, të çdo lloji force, për prodhim pijesh alkoolike	50 lekë/litri	
- 22.08		Alkool etilik jo i denatyrar i një force alkoolike ndaj volumit prej më pak se 80 % vol., për prodhim pijesh alkoolike	50 lekë/litri"	
22.	22.09,	C. Pije joalkoolike, freskuese e të tjera		
		3 000 lekë për 1000 litra.		
	22.01	Ç. Ujë mineral natyral, ujë mineral i gazuar, ujë		
		5		
i imbotiluar				
9.	09.01	D. Kafe		
		- Kafe e papjekur	33 000 lekë për 1000 kg	
		- Kafe e pjekur e bluar ose jo	78 000 lekë për 1000 kg.	
27	27.10	DH. Nënproduktet e naftës		
		- Benzinë deri 89.9 oktan	77	
		- Benzinë 90 oktan e lart	90	
		- Benzinë pa plumb	90	
		- Gazoil	50	
		- Vajguri	80	
		- Valvolinë	50	
		- Vajra lubrifikante të të gjitha llojeve dhe graso	50	
		- Solar, mazut	5	
		- Të tjera (bitum, toluol, silol, sqfur,		
		solvent)	20	
33	33.03.0010	Ë Parfume	50	
33	33.03.0090	F. Ujëra tualeti		50
9/1.		Koks naftë - 5 për qind		

Importimi i çdo lloji nënprodukti naftë, që nuk përfshihet në shkronjën "DH" do të trajtohet me akcizë 90 për qind.

Përrjashtohet nga akciza gaz i lëngut për përdorim në popullsi.

Personat juridikë a fizikë, vendas dhe të huaj, që importojnë alkool për prodhim pijesh alkoolike, do të deklarojnë në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve sasinë e alkoolit që do të importojnë, si dhe do të paraqesin dokumentin për pagesën e akcizës, sipas vlerës së përcaktuar në nenin 1 të këtij ligji.

Neni 3/1

(Shtuar me ligjin nr. 8848, datë 19.12.2001)

Importuesit, prodhuesit dhe tregtarët me shumicë të mallrave me akcizë, regjistrohen si tregtarë të mallrave me akcizë në organet tatimore.

Neni 4

(Ndryshuar me ligjin nr. 8595, datë 6.4.2000; shtuar paragrafi i dytë dhe i tretë me ligjin nr. 8848, datë 19.12.2001)

Për mallrat e prodhuara në vend, akciza e të cilave paguhet me përqindje, llogaritja e akcizës bëhet në bazë të çmimit para tatimit.

Për birrën e prodhuar në vend, llogaritja e akcizës bëhet duke zbatuar mbi sasinë e birrës së prodhuar dhe të deklaruar, përqindjen e akcizës së përcaktuar në nenin 3 të ligjit "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë". Sasia e birrës së deklaruar korrigjohet në rritje, në përpjesëtim të barabartë me masën e tejkalimit të kufirit teknik maksimal të lejueshën të rezes së maltos së përdorur mbi 20 kg për 100 litra birrë të prodhuar.

Tatimpaguesit e regjistruar për prodhimin e birrës ose për importimin dhe tregtimin e maltos, si lëndë e parë për prodhimin e birrës, detyrohen të paguajnë 294 lekë akcizë për kilogram malto të llogaritur në rastet e shitjes së maltos personave të paregjistruar për prodhimin e birrës ose të përdorimit të saj për qëllime të tjera.

Për mallrat e importuara, akciza e të cilave paguhet me përqindje, llogaritja e akcizës bëhet në bazë të vlerës doganore plus taksën doganore.

Neni 5

(Ndryshuar shkronja "a" me ligjin nr. 8848, datë 19.12.2001)

Akciza derdhet në buxhetin e shtetit:

a) *Për mallrat e prodhuara në vend, kur detyrimi nuk paguhet nëpërmjet blerjes së pullës fiskale, akciza llogaritet në çastin e lëvizjes së mallrave nga vendi i prodhimit, dhe deklarohet e paguhet për periudhën 1-15 të muajit brenda 20 të muajit, ndërsa për periudhën 1-31 të muajit deri më datën 5 të muajit pasardhës;*

b) *për mallrat e importuara, në çastin e pagesës së detyrimit të akcizës dhe të taksës doganore në doganë, me përjashtim të rastit të mallrave akciza e të cilave paguhet me pullë fiskale;*

c) *për prodhimet, akciza e të cilave paguhet me pullë fiskale, në çastin e blerjes së pullave, nga subjektet që kanë bërë kërkesë.*

Neni 6

Në rastin e eksportimit të mallrave të parashikuara në nenin 3 nuk llogaritet akcizë dhe nuk jepet asnjë rimbursim.

Neni 7
(Ndryshuar me ligjin nr. 8848, datë 19.12.2001)

Akciza paguhet për importimin dhe prodhimin brenda vendit të mallrave që i nënshtrohen akcizës. Akciza paguhet gjithashtu edhe për mallrat e prodhuara në vend, të cilat prodhohen me lëndë të importuara, që i nënshtrohen akcizës në çastin e importimit.

Importuesit, prodhuesit dhe tregtuesit me shumicë të mallrave, që i nënshtrohen akcizës, për të gjitha shitjet që kryejnë, detyrohen të identifikojnë në faturat tatimore të shitjes emrin, NIPT-in dhe kodin fiskal të tatimpaguesit blerës.

Neni 8

Prodhuesit dhe importuesit e mallrave, që tatohen me akcizë, dhe organet doganore detyrohen të mbajnë llogari të veçantë, të plotësojnë dhe të dërgojnë në organet tatimore deklaratën periodike, mujore për akcizat e realizuara e të derdhura, brenda datës 10 të muajit pasardhës, si dhe çdo informacion tjetër të kërkuar nga Ministria e Financave.

Neni 9
(Shtuar pikat 5, 6 dhe 7 me ligjin nr. 8848, datë 19.12.2001)

Quhen shkelje të këtij ligji:

1. Fshehja dhe falsifikimi i të dhënave dhe i dokumenteve bazë për llogaritjen e akcizave.
2. Mbajtja e gabuar e llogarive kontabël për akcizat.
3. Derdhja me vonesë e akcizave në buxhetin e shtetit.
4. Mosparaqitja në kohë e deklaratës periodike, mujore për akcizat e realizuara.
5. *Importimi, prodhimi, ruajtja, livrimi ose shitja e mallrave, akciza e të cilave paguhet nëpërmjet pullave fiskale, pa blerë këto pulla.*
6. *Importimi, prodhimi, ruajtja, livrimi ose shitja e mallrave të tatueshme me akcizë, pa u regjistruar në oragnet tatimore.*
7. *Mbajtja, me qëllim shitjeje ose konsumi, e mallrave të tatueshme me akcizë, duke njohur që akciza mbi këto mallra nuk ka qenë paguar.*

Neni 10
(Ndryshuar me ligjin nr. 8595, datë 6.4.2000; Shtuar paragrafë me ligjin nr. 8848, datë 19.12.2001)

Shkeljet e parashikuara në nenin 9 të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale formojnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë si vijon:

- Fshehja dhe falsifikimi i akcizave përveç detyrimit të pagimit të akcizës dënohet edhe me një gjobë të barabartë me shumën e kësaj akcize.
- Mbajtja e gabuar e llogarive dënohet me gjobë nga 5 000 (pesë mijë) deri në 10 000 (dhjetë mijë) lekë.
- Për derdhjen me vonesë të akcizave në buxhetin e shtetit, paguhen interesa për pagesë të vonuar në përputhje me ligjin nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.
- Mosparaqitja në kohë e deklaratës periodike mujore për akcizat e realizuara, dënohet me gjobë 6 000 (gjashtë mijë) deri në 8 000 (tetë mijë) lekë.

Procedurat e ankimit dhe të ekzekutimit të masës administrative bëhen në përputhje me ligjin nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

– Importimi, prodhimi, ruajtja, livrimi ose shitja e mallrave, pa pullat fiskale, në rastin kur akciza e tyre paguhet nëpërmjet pullave fiskale, përveç pagimit të shumës së akcizës që lidhet me sasinë e mallit pa pullë fiskale, dënohet edhe me konfiskimin e tyre.

- Importimi, prodhimi, ruajtja, livrimi ose shitja e mallrave të tatueshme me akcizë, pa u regjistruar në organet tatimore, përveç pagimit të shumës së akcizës që duhej paguar, dënohet edhe me konfiskimin e tyre.

- Mbajtja, me qëllim shitjeje ose konsumi, e mallrave që i nënshtrohen akcizës, duke ditur që akciza mbi këto mallra nuk ka qenë paguar, përveç pagimit të shumës së akcizës që lidhet me sasinë e mallit pa pullë fiskale, dënohet edhe me konfiskimin e tyre.

Neni 11

Ngarkohen Ministria e Financave dhe Banka e Shqipërisë të marrin masa për prodhimin e pullave për artikujt e duhanit dhe të pijeve alkoolike.

Neni 11/1

(Shtuar me ligjin nr. 8716, datë 15.12.2000)

Nga sasia e pullave fiskale të tërhequra nga tatimpaguesi (prodhues dhe importues cigaresh), 0.5 për qind e saj pranohet si pullë fiskale e dëmtuar dhe hedhurinë.

Kjo sasi pullash fiskale, të dëmtuara brenda vitit kalendarik, do të zëvendësohet me pulla të reja fiskale dhe subjekti është i detyruar të paguajë vetëm vlerën e vetë pullës.

Neni 11/2

(Shtuar me ligjin nr. 8716, datë 15.12.2000)

Ministria e Financave dhe Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit përcaktojnë kategorinë për çdo lloj cigareje.

Neni 12

Ligji nr.8348, datë 20.5.1998 “ Për akcizat në Republikën e Shqipërisë” shfuqizohet.

Neni 13

Ngarkohet Ministria e Financave për nxjerrjen e akteve nënligjore, në bazë dhe për zbatim të këtij ligji.

Neni 13/1

(Shtuar me ligjin nr. 8848, datë 19.12.2001)

Për frot, që ndodhin gjatë procesit të përpunimit dhe prodhimit të produkteve, zbritja lejohet në kufijtë e firove teknikisht të pranueshme, të përcaktuara nga Ministria e Financave dhe ministria përkatëse.

Neni 14

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2288, datë 31.12.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**